



MEHMET PASHË DERALLA
FIGURË E SHQUAR POLITIKE
DHE USHTARAKE

Dorian KOÇI

Kujtesa historike është një proces që mund të punojë në dy drejtime. Drejtimi i parë është ai përkujtimor që është dhe varianti më i përhapur dhe që nënkupton se vlerat, idetë dhe personazhet i shërbejnë kombit, vazhdimisht për të mbajtur gjallë ndërgjegjen kombëtare. Dhe, i dyti, është drejtimi mohues që është variant më pak i përhapur dhe që nënkupton që ngjarjet, personazhet apo vlerat “harrohen”, sërish për t’i shërbyer interesave kombëtare. Një rast i tillë është p.sh. ai i Zvicrës, ku lufta e konfederatave më 1846 harrohet dhe nuk përmendet, për t’i mëshuar më fort identitetit zviceran të të tre kantoneve.

Në Shqipëri, për shumë arsye që kanë të bëjnë me rastin specifik të saj në historinë e Ballkanit, por edhe pse zakonisht modelet janë marrë të gatshme nga jashtë, është përqaftuar drejtimi i parë, ndaj dhe njerëzit dhe shoqëria janë shumë të ndjeshëm ndaj çdo mohimi apo denigrimi të atyre që janë pranuar prej kohësh si vlera të mirëfillta kombëtare dhe personazhe të rëndësishme që kanë mbizotëruar historinë e vendit. Sigurisht që në këtë qasje shqiptare ka vend dhe për korrigjim apo dhe për një ç’mimizim që shpesh herë është vënë re në trajtimin e çështjeve dhe ngjarjeve të ndryshme historike, por pavarësisht faktit që kohët e fundit ka shumë përpjekje për rivlerësim apo rebalancim të këtyre vlerave, duke u përpjekur për të rishkruar historinë, besoj se është e nevojshme që një histori e përgjithshme e kombit shqiptar nuk mund të shtrihet vetëm brenda kufijve administrativë të Shqipërisë.

Deklarata e pavarësisë së Shqipërisë shpreh vullnetin e gjithë përfaqësuesve të kombit shqiptar nga të gjitha krahinat, vullnet që është i reflektuar dhe në përbërjen e qeverisë së parë të Shqipërisë së pavarur. Mes personaliteteve të ndryshme që nga aktivistë dhe patriotë të Rilindjes Kombëtare u kthyen në ministra, është dhe Mehmet Pashë Deralla, ministri i parë i Luftës të shtetit të pavarur shqiptar. Shqiptarët etnikë të Maqedonisë, kanë nxjerrë personalitete të ndryshme që kanë kontribuar në krijimin dhe sendërtimin e idesë kombëtare të shqiptarëve, duke pasqyruar më së miri kombinimin e elementit të zgjimit kombëtar, si është rasti i Dervish Himës, Josif Bagerit, me elementin e forcës si është rasti i Dervish Carës dhe Mehmet Pashë Derallës.

Mehmet Pashë Deralla është një figurë politike e ushtarake, për të cilin është folur e studiuar pak. Është e pafalshme që Ministri i parë i luftës, njeriu që ka ngritur me kontributin e tij Ministrinë e Mbrojtjes, nuk ka ende në Shqipëri një bust apo memorial për ta përkujtuar dhe akoma më keq në ndërgjegjen e memorien e brezit të ri nuk ka zënë vendin që meriton. Situatat e trazuara politike të Shqipërisë së pas shpalljes së pavarësisë nuk kanë pse të vazhdojnë ende të shpërndajnë mjegull dhe studimet e mirëfillta historike duhen të marrin udhë. Në këtë kontekst, shpresoj shumë se ky botim do të shërbejë sado pak për të shkundur opinionin e Instituteve të Historisë në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, për të filluar një punë përgatitore, në mënyrë që viti 2018 që përkon dhe me 100-vjetorin e shuarjes nga jeta të Mehmet Pashë Derallës, të jetë një vit i botimeve cilësore rreth kontributit të këtij personaliteti të shtetit shqiptar.